

**V E N D I M**  
**Nr.481, datë 22.10.1999**

**PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE CROSS BORDER COOPERATION  
(CBC) ME ITALINË DHE GREQINË PËR VITIN 1999, NË KUADRIN E PROGRAMIT  
PHARE TË KOMISIONIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Programit Cross Border Cooperation (CBC) Shqipëri-Greqi për vitin 1999, për shumën grant prej 7 milionë EURO-sh.
  2. Miratimin e Programit Cross Border Cooperation (CBC) Shqipëri-Itali për vitin 1999, për shumën grant prej 7 milionë EURO-sh.
  3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e projektit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**